



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 6.9.2023

Nr: 762

Ora: 16:30

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË” PËR  
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË  
KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023**

Sot më datë 6.9.2023, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur në datë 31.8.2023, me:

**Kërkues:** Partia politike “Partia Demokratike e Shqipërisë”, me kryetar z. Nard Ndoka

**Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Partia Demokratike e Shqipërisë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023

**Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 186, datë 11.8.2023, ka caktuar datën 24 Shtator 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës.

“Partia Demokratike e Shqipërisë”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Nard Ndoka, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, që do të zhvillohen më datë 24 shtator 2023.

Data: 6.9.2023 Nr: 762  
Ora: 16:30



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Demokratike e Shqipërisë” për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”.

Nga partia politike “Partia Demokratike e Shqipërisë” është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Demokratike e Shqipërisë”, me iniale “PDK”, me kryetar z. Nard Ndoka, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Demokratike e Shqipërisë” me shkronja nistore “PDK”, Rruga “Muhamet Gjollësia”(ish Shtëpia Botuese e Librit Shkollor 8 Nëntori), Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Nard Ndoka, me adresë, Rruga “Sheh Ahmet Pazari” nr. 147, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është zj. Ariona Hoxha me adresë Rruga “5 Maji”, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është zj. Ariona Hoxha, me adresë, Rruga “5 Maji”, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”, respekton afatin kohor të parashikuar në nenin 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92 /2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 1, datë 18.1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, dhe vendimit të Komisionit Rregullator nr. 28 datë 16.8.2023 “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkinë Kukës, që do të zhvillohen më datë 24 Shtator 2023”.

## VENDOS:

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Demokristiane e Shqipërisë”, me kryetar z. Nard Ndoka, me shkronjat nistore “PDK”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**